



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr. 759/ 7 prot

Datë 03.06.2022

**V E N D I M**  
**K.P.P. 529/2022**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 03.06.2022 shqyrtoi ankesat me:

**Objekt:** Shfuqizim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Luar Bros” SHPK në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF-21171-03-03-2022 me objekt: “Blerje vula sigurie”, me fond limit 5.246,430 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 15.03.2022 nga autoriteti kontraktor, Albpetrol SH.A.

**Ankimues:** Operatori ekonomik “Luar Bros” SHPK  
Adresa: Rruga “Nasi Pavllo”, Pallati nr. 15/1, Shkalla 1, Tiranë.

**Autoriteti Kontraktor:** Albpetrol SHA  
Adresa: Lagjja “29 Marsi”, Rruga Fier – Patos, km 7, Patos.

**Subjekt i Interesuar:** Operatori ekonomik “Power Industries” SHPK  
Adresa: Picar, Vorë, Tiranë.

**Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për

*miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik” , Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.*

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

## **Vëren:**

### **I**

#### *Vlerësimi paraprak*

I.1. Vlera limit e përlllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga 3 anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

### **II**

#### *Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 04.03.2022, është publikuar në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik, SPE, procedura e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF-21171-03-

03-2022 me objekt: “Blerje vula sigurie”, me fond limit 5.246,430 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 15.03.2022 nga autoriteti kontraktor, Albpetrol SH.A.

II.2. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE) si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor në datë 15.03.2022 ka kryer vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. “Arteo 2018” SHPK	3.997.280 lekë	skualifikuar
2. “Luar Bros” SHPK	4.097.212 lekë	skualifikuar
3. “Power Industries” SHPK	4.846.702 lekë	kualifikuar

II.3. Operatori ekonomik ankimues “Luar Bros” SHPK rezulton i skualifikuar nga procedura e prokurimit për arsyet si më poshtë:

*“Autorizimi i prodhuesit i paraqitur është lëshuar nga kompania “Gökerplast” Turqi. Pas komunikimit zyrtar me e-mail që KVO pati me prodhuesin, rezulton se ky autorizim nuk është i vlefshëm.”*

II.4. Në datën 12.04.2022, autoriteti kontraktor ka publikuar Njoftimin e Fituesit në sistemin e prokurimit elektronik (SPE) dhe në datë 01.11.2021 është publikuar Njoftimi i Fituesit në Buletinin Nr. 50, datë 19.04.2022, në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik, ku rezulton fitues, operatori ekonomik “Power Industries” SHPK.

II.5. Në datën 12.04.2022, operatori ekonomik “Luar Bros” SHPK ka paraqitur ankesë njëkohësisht pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor duke kundërshtuar vendimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me skualifikimin e ofertës së tij ekonomike.

II.6. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe me anë të formularit të publikimit nr. 759/2 prot., datë 13.04.2022, u publikua arsyeja e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues.

II.7. Me shkresën nr. 3169/3 prot, datë 21.04.2022 me objekt: “Dërgohet Vendimi mbi ankesën e operatorit ekonomik “Luar Bros” ShPK për procedurën e prokurimit me objekt “Blerje Vula Sigurie”, me REF-21171-03-03-2022”, protokolluar me tonën me shkresën nr. 759/3 prot datë 26.04.2022, është dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik vendimi i autoritetit kontraktor mbi trajtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “Luar Bros” SHPK për procedurën

e mësipërme të prokurimit, ku rezulton se autoriteti kontraktor ka vendosur mospranimin e ankesës, refuzimin e saj.

II.8. Në datën 05.05.2022, Komisioni Prokurimit Publik i është drejtuar, me anë të emailit kompanisë prodhuese *Gokerplast* Ltd, e cila ka lëshuar dokumentin Autorizim Prodhesi për operatorin ekonomik “*Luar Bros*” SHPK më datë 05.05.2022, në adresat e emailit [emre.goktug@gokerplast.com](mailto:emre.goktug@gokerplast.com) dhe [info@gokerplast.com](mailto:info@gokerplast.com) (adresa të gjendur në dokumentacionin e paraqitur nga ankimesi), duke i kërkuar informacion si më poshtë: *“I nderuar zotëri/zonjë, Komisioni i Prokurimit Publik, në cilësinë e një organi të pavarur, shqyrton ankesat e procedurave të prokurimit publik në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me ligjin nr. 162/2020, datë, 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”. Unë po ju drejtohem në emër të Komisionit të Prokurimit Publik (KPP) në lidhje me një ankesë të paraqitur kohët e fundit pranë KPP -së. Tema kryesore e kësaj ankese lidhet me autorizimin e prodhuesit të datës 04.03.2022 të lëshuar nga kompania juaj Gokerplast me adresë në Merdivenkoy, Dikyo Sk. 2B D:151, 34732 Kadikoy/Instambul prodhues i vulave të sigurisë për operatorin ekonomik “Luar Bros” SHPK, 1- Ky autorizim i lëshuar nga ana juaj ku autorizoni operatorin ekonomik “Luar Bros” SHPK A është i vlefshëm. Me qëllim gjykimin sa më të drejtë dhe transparent të ankesës, mbetemi në pritje të një përgjigjeje sa më të shpejtë nga ana juaj. Duke ju falenderuar për bashkëpunimin, bashkëngjitur gjeni kopje te autorizim prodhuesit. Dear sir/madam, The Public Procurement Commission, in the capacity of an independent body, examines complaints of public procurement procedures in the Republic of Albania, in accordance with Law no. 162/2020, dated 23.12.2020 “On Public Procurement”. I am addressing you on behalf of the Public Procurement Commission (CPC) regarding a recent appeal filed with the PCP. The main topic of this complaint relates to the authorization of the manufacturer dated 04.03.2022 issued by your Gokerplast company with Merdivenkoy address, Dikyo SK. 2B D: 151, 34732 Kadikoy/Instambul Producer of Safety Seals for Economic Operator “Luar Bros” Ltd, 1- This authorization issued by you where you authorize the economic operator “Luar Bros” Ltd is valid? In order to judge the fairer and transparent of the complaint as soon as possible, we are waiting for a faster response from you, Thanks to you for the cooperation, attaching you find copies of the manufacturer authorization. Thanking you”*. Bashkëlidhur këtij emaili, Komisioni i Prokurimit Publik, i ka paraqitur kompanisë prodhuese dokumentin Autorizim Prodhesi të lëshuar nga kompania prodhuese *Gokerplast* Ltd, më datë 04.03.2022, në emër të operatorit ekonomik “*Luar Bros*” SHPK.

II.9. Në datën 05.05.2022 në emalin zyrtar të institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik, protokolluar në institucionin tonë me nr. 759/6, datë 17.05.2022, kompania prodhuese *Gokerplast* Ltd, i ka kthyer përgjigje kërkesës tonë, nëpërmjet z. Emre GOKTUG Manager (me adresë emaili [omer.goktug@gokerplast.com](mailto:omer.goktug@gokerplast.com), ku informon se: *“Hello madam/sir, Hope all is good.*

*The document in the attachment was issued to Luar Bros accidentally. We have received the same inquiry for the same tender from two different companies (Luar Bros & Power Industries Shpk), and our sales team issued Manufacturer's Authorization to both of them. After realizing this mistake, we have told Luar Bros that we will participate in this tender with Power Industries, as they're are the one who contacted us first. Please feel free to contact me if you have more questions..". "Pershendetje zonjë/zotëri, Shpresoj se gjithçka të jetë mirë. Dokumenti bashkëlidhur iu dha Luar Bros aksidentalisht. Ne kemi marrë të njëjtën kërkesë për të njëjtin tender nga dy kompani të ndryshme (Luar Bros SHPK dhe Power Industries SHPK), dhe ekipi ynë i shitjeve lëshoi autorizimin e prodhuesit për të dy. Pasi e kuptuam këtë gabim, ne i kemi thënë Luar Bros se do të marrim pjesë në këtë tender me Power Industries SHPK, pasi ato janë të parët që na kontaktuan. Ju lutem mos ngurroni të më kontaktoni nëse keni më shumë pyetje".*

II.10. Komisioni Prokurimit Publik me qëllimi gjykimin sa më të drejtë dhe transparent në datën 13.05.2022 nëpërmjet shkresës nr. 759/4 prot, i është drejtuar operatorit ekonomik dhe autoritetit kontraktor nga të cilët ka kërkuar si më poshtë vijon:

*[...]Komisioni Prokurimit Publik nga korrespondenca e sipërcituar me kompaninë prodhuese Gokerplast Ltd konstaton se jeni vënë në dijeni se në këtë procedurë prokurimi kompania Gokerplast Ltd do të marrë pjesë me operatorin ekonomik "Power Industries" SHPK, pasi ato janë të parët që na kontaktuan". Të ndodhur në këto kushte dhe me qëllim gjykimin sa më drejtë dhe transparent të ankesës së paraqitur, në zbatim të ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative" si dhe nenit 30 pika 2, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 "Për miratimin e rregullave "Për Organizimin dhe Funkionimin e Komisionit të Prokurimit Publik", Komisioni i Prokurimit Publik gjykon të nevojshëm që ju si operator ekonomik të na vini në dispozicion prova shtesë zyrtare, korrespondencë me prodhuesin duke na faktuar nëse jeni vënë në dijeni nga kompania "Gokerplast" Ltd në lidhje me refuzimin e autorizimit të prodhuesit, apo autorizimi i prodhuesit i datës 04.03.2022 të lëshuar nga kompania juaj Gokerplast për operatorin ekonomik "Luar Bros" SHPK ka qenë i vlefshëm deri më datën 15.03.2022, data e zhvillimit të procedurës. Këto prova duhet të paraqiten pranë Komisionit të Prokurimit Publik brenda ditës së Hënë datë 16.05.2022 ora 09:30.[....]*

II.11. Me datë 17.05.2022 me shkresën me objekt: "Kthim-përgjigje shkresës nr. 759/4 prot, datë 13.05.2022 Kërkesë për Dokumentacion", protokolluar me tonën me shkresën nr. 759/5 prot datë 17.05.2022, është dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacion dhe dokumentacion nga ana e operatorit ekonomik ankimues "Luar Bros" SHPK, në përgjigje të kërkesës së bërë nga Komisioni Prokurimit Publik.

II.12. Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ rezulton, se operatori ekonomik i interesuar "Power Industries" SHPK nuk ka dorëzuar argumente në përputhje me nenin 113 të LPP-së, në formë shkresore dhe në sistemin e ankesave elektronike.

### III

#### Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit paraprak të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, si edhe informacionit të autoritetit kontraktor,

#### Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Luar Bros” SHPK për sa i përket arsyes së skualifikimit të ofertës së tij ekonomike me argumentin se “[...]“Autorizimi i prodhuesit i paraqitur është lëshuar nga kompania “Gökerplast” Turqi. Pas komunikimit zyrtar me e-mail që KVO pati me prodhuesin, rezulton se ky autorizim nuk është i vlefshëm. [...]”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në dokumentet e tenderit, Shtojca 7/2 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 2.3.2 “Kapaciteti teknik”, nga autoriteti kontraktor është përcaktuar kriteri:

2.3.2. *Operatori ekonomik duhet të paraqes autorizim prodhuesi ose distributori të autorizuar për mallrat e kërkuara. Në rast se do të paraqitet autorizim nga distributori duhet të provohet lidhja midis prodhuesit dhe distributorit. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: tel, fax, email, website, kjo e nevojshme për AK në rast verifikimi nga ana e tij.*

III.1.2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të operatorit ekonomik “Luar Bros” ShPK, rezulton, se është paraqitur në përmbushje të kriterit të sipërcituar:

- Dokumentin “Autorizim Prodhuesi, datë 04.03.2022, të lëshuar nga kompania prodhuese Gokerplast Ltd”.

III.1.3. Neni 2 “Qëllimi i ligjit” 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se: *Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.*

III.1.4. Neni 3 Parime të përgjithshme 1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprimet me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.

III.1.5. Neni 21 Autoriteti ose enti kontraktor 1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III.1.6. Neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie”

III.1.7. Në nenin 40 pika 1, 2 dhe 6 të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“1. Në procedurat e prokurimit për mallra, autoriteti/enti kontraktor parashikon sasinë e mallrave që do të lëvrojë, si dhe grafikun e lëvrimit të mallrave.

2. Për mallrat që do të prokurohen, autoritetet/entet kontraktore parashikojnë specifikimet teknike, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme

*përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36, të LPP-së, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara.*

*3. Autoriteti/enti kontraktor mund t'u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:*

*a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose*

*b) fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose*

*c) dëshmi për rezultatet e testeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.”.*

III.1.8. Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Gjithashtu një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato.

Gjithashtu, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës.

III.1.9. Nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit, vërejmë se autoriteti kontraktor në kriteret e veçanta të kualifikimit ka kërkuar shprehimisht që *operatori ekonomik duhet të paraqes*



*autorizim prodhuesi ose distributori të autorizuar për mallrat e kërkuara. Në rast se do të paraqitet autorizim nga distributori duhet të provohet lidhja midis prodhuesit dhe distributorit. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: tel, fax, email, website, kjo e nevojshme për AK në rast verifikimi nga ana e tij.*

Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar në sistemin e prokurimit elektronik, nga operatori ekonomik ankimues “Luar Bros” SHPK, konstatohet, se ky i fundit ka paraqitur dokumentin Autorizim Prodhuësi datë 04.03.2022, të lëshuar nga kompania prodhuëse Gokerplast Ltd, e cila autorizon operatorin ekonomik “Luar Bros” SHPK për procedurën e tenderit me nr ref 21171-03-03-2022, me objekt “Blerje vula sigurie” .

III.1.10. Komisioni i Prokurimit Publik, nisur nga pretendimet e operatorit ekonomik ankimues, i cili pretendon se “Autorizimi i Prodhuësit i paraqitur prej tij është i vlefshëm”, si dhe referuar informacionit dhe dokumentacionit të paraqitur nga autoriteti kontraktor, ku konstatohet se nga ana e tij janë kryer verifikime pranë kompanisë prodhuëse dhe rezulton se për këtë procedurë prokurimi, kompania prodhuëse shprehet se: “gjithsesi për këtë tender, rishitësi ynë i autorizuar është “Power Industries” SHPK. Letra e autorizimit për këtë kompani është e vlefshme”, KPP iu drejtua me anë të emailit zyrtar të institucionit tonë, kompanisë prodhuëse e cila ka lëshuar dokumentin.

Konkretisht, KPP në datë 05.05.2022, Komisioni Prokurimit Publik i është drejtuar, me anë të emailit kompanisë prodhuëse Gokerplast Ltd, e cila ka lëshuar dokumentin Autorizim Prodhuësi për operatorin ekonomik “Luar Bros” SHPK më datë 05.05.2022, në adresat e emailit [emre.goktug@gokerplast.com](mailto:emre.goktug@gokerplast.com) dhe [info@gokerplast.com](mailto:info@gokerplast.com) (adresa të gjendur në dokumentacionin e paraqitur nga ankimuesi), duke i kërkuar informacion si më poshtë: “I nderuar zotëri/zonjë, Komisioni i Prokurimit Publik, në cilësinë e një organi të pavarur, shqyrton ankesat e procedurave të prokurimit publik në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me ligjin nr. 162/2020, datë, 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”. Unë po ju drejtohem në emër të Komisionit të Prokurimit Publik (KPP) në lidhje me një ankesë të paraqitur kohët e fundit pranë KPP -së. Tema kryesore e kësaj ankese lidhet me autorizimin e prodhuësit të datës 04.03.2022 të lëshuar nga kompania juaj Gokerplast me adresë në Merdivenkoy, DikyoL Sk. 2B D:151, 34732 Kadikoy/Instambul prodhuësi i vulave të sigurisë për operatorin ekonomik “Luar Bros” SHPK, I- Ky autorizim i lëshuar nga ana juaj ku autorizoni operatorin ekonomik “Luar Bros” SHPK A është i vlefshëm. Me qëllim gjykimin sa më të drejtë dhe transparent të ankesës, mbetemi në pritje të një përgjigjeje sa më të shpejtë nga ana juaj. Duke ju falenderuar për bashkëpunimin, bashkëngjitur gjeni kopje te autorizim prodhuësit. Dear sir/madam, The Public Procurement Commission, in the capacity of an independent body, examines complaints of public procurement procedures in the Republic of Albania, in accordance with Law no. 162/2020, dated 23.12.2020 “On Public Procurement”. I am addressing you on behalf of the Public Procurement Commission (CPC) regarding a recent appeal filed with the PCP. The main topic of this complaint relates to the authorization of the manufacturer dated 04.03.2022 issued by your Gokerplast company with Merdivenkoy address, DikyoL SK. 2B D: 151, 34732

*Kadikoy/Instambul Producer of Safety Seals for Economic Operator “Luar Bros” Ltd, 1- This authorization issued by you where you authorize the economic operator “Luar Bros” Ltd is valid? In order to judge the fairer and transparent of the complaint as soon as possible, we are waiting for a faster response from you, Thanks to you for the cooperation, attaching you find copies of the manufacturer authorization. Thanking you,”.* Bashkëlidhur këtij emaili, Komisioni i Prokurimit Publik, i ka paraqitur kompanisë prodhuese dokumentin Autorizim Prodhuesi të lëshuar nga kompania prodhuese Gokerplast Ltd, më datë 04.03.2022, në emër të operatorit ekonomik “Luar Bros” SHPK.

Në datën 05.05.2022 në emalin zyrtar të institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik, protokolluar në institucionin tonë me nr. 759/6, datë 17.05.2022, kompania prodhuese Gokerplast Ltd, i ka kthyer përgjigje kërkesës tonë, nëpërmjet z. Emre GOKTUG Manager (me adresë emaili [omer.goktug@gokerplast.com](mailto:omer.goktug@gokerplast.com), ku informon se: *“Hello madam/sir, Hope all is good. The document in the attachment was issued to Luar Bros accidentally. We have received the same inquiry for the same tender from two different companies (Luar Bros & Poëer Industries Shpk), and our sales team issued Manufacturer’s Authorization to both of them. After realizing this mistake, we have told Luar Bros that we will participate in this tender with Power Industries, as they’re are the one who contacted us first. Please feel free to contact me if you have more questions..”.* “Pershendetje zonjë/zotëri, Shpresoj se gjithçka të jetë mirë. Dokumenti bashkëlidhur iu dha Luar Bros aksidentalisht. Ne kemi marrë të njëjtën kërkesë për të njëjtin tender nga dy kompani të ndryshme (Luar Bros SHPK dhe Power Industries SHPK), dhe ekipi ynë i shitjeve lëshoi autorizimin e prodhuesit për të dy. Pasi e kuptuam këtë gabim, ne i kemi thënë Luar Bros se do të marrim pjesë në këtë tender me Power Industries SHPK, pasi ato janë të parët që na kontaktuan. Ju lutem mos ngurroni të më kontaktoni nëse keni më shumë pyetje”. Pra, kompania prodhuese Gokerplast Ltd, në përgjigjen së mësipërme deklaroi se, *“Ne kemi marrë të njëjtën kërkesë për të njëjtin tender nga dy kompani të ndryshme (Luar Bros SHPK dhe Power Industries SHPK), dhe ekipi ynë i shitjeve lëshoi autorizimin e prodhuesit për të dy”.*

Nga shqyrtimi i ankesës së operatori ekonomik “Luar Bros” SHPK dhe dokumentacionit bashkëlidhur saj, konstatohet se ky i fundit ka paraqitur dokumentin “Autorizim Prodhuesi”, datë 04.03.2022, të lëshuar nga kompania Gokerplast Ltd, në të cilin deklarohet se *“Gokterplast ltd me vendodhje në Merdivenkoy Dikyo Sk. 2/B D: 151, 34732 Kadikoy/Stamboll si prodhues i vulave të sigurisë autorizon “Luar Bros” SHPK me NIPT L72322004M me adresë: Rruga “Nasi Pavllo”, pall 15/1, Shkalla 1. Ap nr. 1, Tiranë Shqipëri, për të paraqitur një ofertë, negociuar dhe shitur produktet tona tek SHA Albpetrol për procedurën e tenderit Blerje Vula Sigurie me nr. Ref-21171-03-03-2022. Asnjë kompani tjetër përveç “Luar Bros” SHPK nuk është autorizuar të Ofrojë dhe të nënshkruajë kontratë për mallrat tona për këtë procedurë tenderi. Shënim: Ky autorizim është i vlefshëm edhe nëse data e tenderit dhe numri i referencës janë ndryshuar”.* Sa më sipër pasqyruar, kompania prodhuese Gokterplast Ltd në përgjigje të kërkesës tonë me email në datë 05.05.2022, deklaroi se: *“Përshëndetje zonjë/zotëri, Shpresoj se gjithçka të jetë mirë. Dokumenti bashkëlidhur iu dha “Luar Bros” aksidentalisht. Ne kemi marrë të njëjtën kërkesë*

*për të njëjtin tender nga dy kompani të ndryshme (Luar Bros dhe Power Industries SHPK), dhe ekipi ynë i shitjeve lëshoi autorizimin e prodhuesit për të dy. Pasi e kuptuam këtë gabim, ne i kemi thënë Luar Bros se do të marrim pjesë në këtë tender me Power Industries SHPK, pasi ato janë të parët që na kontaktuan. Ju lutem mos ngurroni të më kontaktoni nëse keni më shumë pyetje”, ndërkohë referuar dokumentacionit të dorëzuar nga ankimuesi bashkëlidhur ankesës së tij, konkretisht dokumentit “Autorizim Prodhuesi”, datë 04.03.2022, të lëshuar nga kompania Gokterplast.Ltd, konstatohet se kjo e fundit, autorizon “Luar Bros” SHPK për të marrë pjesë dhe shitur produktet e Gokterplast Ltd tek “Albpetrol” SHA për procedurën e tenderit “Blerje Vula Sigurie” me nr. Ref-21171-03-03-2022.*

*Për një gjykim sa më të drejtë dhe transparent Komisioni Prokurimit Publik më datën 13.05.2022 nëpërmjetë shkresës nr. 759/4 prot, i është drejtuar operatorit ekonomik dhe autoritetit kontraktor nga të cilët ka kërkuar si më poshtë vijon: [...]Komisioni Prokurimit Publik nga korespondenca e sipërcituar me kompanin prodhuese Gokerplast Ltd konstaton se jeni vënë në dijeni se në këtë procedurë prokurimi kompania Gokerplast Ltd do të marrë pjesë me operatorin ekonomik “Power Industries” SHPK, pasi ato janë të parët që na kontaktuan”. Të ndodhur në këto kushte dhe me qëllim gjykimin sa më drejtë dhe transparent të ankesës së paraqitur, në zbatim të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative” si dhe nenit 30 pika 2, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon të nevojshëm që ju si operator ekonomik të na vini në dispozicion prova shtesë zyrtare, korrespondencë me prodhuesin duke na faktuar nëse jeni vënë në dijeni nga kompania “Gokerplast” Ltd në lidhje me refuzimin e autorizimit të prodhuesit, apo autorizimi i prodhuesit i datës 04.03.2022 të lëshuar nga kompania juaj Gokerplast për operatorin ekonomik “Luar Bros” SHPK ka qenë i vlefshëm deri më datën 15.03.2022, data e zhvillimit të procedurës. Këto prova duhet të paraqiten pranë Komisionit të Prokurimit Publik brenda ditës së Hënë datë 16.05.2022 ora 09:30.[...]. Me datë 17.05.2022 me shkresën me objekt: “Kthim përgjigje shkresës nr. 759/4 prot, datë 13.05.2022 Kërkesë për Dokumentacion”, protokolluar me tonën me shkresën nr. 759/5 prot datë 17.05.2022, është dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacion dhe dokumentacion nga ana e operatorit ekonomik ankimues “Luar Bros” SHPK, në përgjigje të kërkesës së bërë nga Komisioni Prokurimit Publik”. Nga verifikimi i informacionit korrespondencës midis operatorit ekonomik “Luar Bros” SHPK dhe kompanisë “Gokterplast” Ltd, por dhe korrespondencës me Komisionin e Prokurimit Publik me prodhuesin “Gokterplast” Ltd, në asnjë moment nuk konstatohet që kompania prodhuese “Gokterplast” Ltd të ketë vërtetuar me anë të dokumentacionit, se autorizimi i datës 04.03.2022 i lëshuar për operatorin “Luar Bros” SHPK është i shfuqizuar apo shpallur i pavlefshëm përpara momentit të zhvillimit të procedurës.*

*Sa më sipër, KPP konstaton se, dokumenti “Autorizimi prodhuesi”, në emër të shoqërisë “Luar Bros” SHPK, është lëshuar nga prodhuesi në datë 04.03.2022, ndërsa procedura e prokurimit objekt-ankimi është zhvilluar nga autoriteti kontraktor në datë 15.03.2022. Ndërkohë operatori*

ekonomik ankimues ka paraqitur bashkëlidhur ankesës së tij dokumentin “*Autorizim Prodhuesi*”, të lëshuar nga prodhuesi në datë 04.03.2022. Pra, referuar dokumentacionit të mësipërm, si dhe vetë deklarimeve të kompanisë prodhuese, konstatohet se dokumenti “*Autorizimi prodhuesi*”, i datës 04.03.2022, ka qenë i vlefshëm në momentin e zhvillimit të procedurës, duke vërtetuar kështu faktin se midis prodhuesit “Gokterplast” Ltd dhe operatorit ekonomik “*Luar Bros*” SHPK, ekziston një marrëdhënie tregtare sipas disa kushteve të caktuara, për të cilat KPP nuk mund të japë opinionin e saj. Me anë të autorizimit të prodhuesit, një kompani autorizon, si dhe i delegon disa tagre, në lidhje me të drejtën për tregtimin e produkteve të tij, një kompanie tjetër. Në rastin konkret, operatori ekonomik ankimues, ashtu siç pranohet nga vetë kompania prodhuese, disponon një dokument të vlefshëm për pjesëmarrjen në procedurën e prokurimit. Ndërkohë, nga korrespondenca me kompaninë prodhuese, ky i fundit pranon vlefshmërinë e dokumentit të paraqitur nga ankimuesi “*Luar Bros*” SHPK, por deklaroi pas momentit të zhvillimit të procedurës se për procedurën konkrete të prokurimit, ka autorizuar kompaninë “*Powr Industries*” SHPK, por në asnjë prej komunikimeve, kompania prodhuese, nuk vërteton se ka njoftuar operatorin ekonomik “*Luar Bros*” SHPK, për heqjen e së drejtës së tregtimit të produkteve të tij në procedurën konkrete të prokurimit, përpara datës së zhvillimit të tenderit, pra përpara datës 15.03.2022.

Sa më sipër, në asnjë moment nuk vërtetohet se operatori ekonomik ankimues “*Luar Bros*” SHPK, në momentin e zhvillimit të procedurës së prokurimit, ka pasur dijeni në lidhje me heqjen, nga kompania prodhuese, të autorizimit për pjesëmarrjen në procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi dhe për sa kohë nuk vërtetohet e kundërta, dokumenti “*Autorizimi prodhuesi*”, i datës 04.03.2022, i paraqitur nga operatori ekonomik “*Luar Bros*” SHPK, do të konsiderohet i vlefshëm.

Akoma më tej vlen të theksojmë, se autoriteti kontraktor disponon të gjitha elementet e nevojshme procedurale, si garanci, në rast të shkeljes së kontratës, konkretisht neni 83 “*Sigurimi i ofertës*” i Ligjit nr.162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, si dhe nenet 36 “*Sigurimi i kontratës*”, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar.

Gjithashtu, Komisioni i Prokurimit Publik sqaron, se në bazë të nenit 124 “*Detyrimet e autoritetit ose entit kontraktor gjatë zbatimit të kontratës*” të LPP, si dhe nenit 107 dhe 108 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, autoriteti kontraktor ka një rol të posaçëm, për vetëcilësimin e tij ligjor, si autoriteti me interes dhe përgjegjësi thelbësore për realizimin e suksesshëm të kontratës. KPP sjell në vëmendje, se referuar rregullave të prokurimit publik, është pikërisht autoriteti kontraktor ai që duhet të monitorojë zbatimin e kontratës, për t’u siguruar nëse cilësia e mallit do të jetë e njëjtë me cilësinë dhe specifikimet teknike të premtuara në ofertë dhe të përcaktuara në kontratë. Në rast të shkeljes së kushteve të kërkuara, autoriteti kontraktor zbaton penalitetet e parashikuara në kontratë, apo detyrimet, në mbështetje të ligjit dhe rregullave për prokurimin publik, si më sipër cituar.

Pra, operatori ekonomik ankimues “Luar Bros” SHPK, me dokumentacionin e paraqitur, plotëson kriterin e përcaktuar nga autoriteti kontraktor në kriteret e veçanta të kualifikimit, në lidhje me autorizimin e prodhuesit.

Rrjedhimisht, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

### **Vendos**

1. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Luar Bros” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF-21171-03-03-2022 me objekt: “Blerje vula sigurie”, me fond limit 5.246,430 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 15.03.2022 nga autoriteti kontraktor, Albpetrol SH.A.
  2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së për skualifikimin e operatorit ekonomik “Luar Bros” SHPK, dhe të korrigjojë shkeljet e konstatuara si më sipër, duke e kualifikuar këtë operator ekonomik.
  3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi duke dokumentuar veprimet e kryera.
  4. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Luar Bros” SHPK.
  5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
  6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Kryetar**  
**Jonaid Myzyri**